



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2023:217883

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05817898

**C.nr.281/23**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, si gjykatë civile e shkallës së parë, nga gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen civile të paditësit I. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit, i përfaqësuar nga B. Q. – B. nga fsh..., Komuna Dragash, kundër të paditurit E. Q. po ashtu nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. A. J. nga Prizreni, me objekt të padisë pengim posedimi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 13.05.2024 mori ndërsa me datë 12.06.2023 përpiloj edhe këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** padia dhe kërkesëpafia e paditësit I. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit, përfaqësuar nga B. Q. – B.

**II. VËRTETOHET** se i padituri E. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit me datën 15.09.2021 me ndërtimin e murit mbajtës të derës hyrëse në ngastrën kadastrale Nr.004..-0 ZK B. me gabarit 8.25 x 4.40 m, me strehë në lartësi prej 3.40m dhe në distancë prej 0.37m nga shtëpia e paditësit I. Q. e cila ndodhët në ngastrën kadastrale 004..-0 ZK B. e ka penguar paditësin I. Q. në posedimin e lirë dhe të fundit faktik të paluajtshmërisë – shtëpisë së ndërtuar në ngastrën kadastrale Nr.4..-0 ZK B., Komuna Dragash, ashtu që i pamundëson izolimin e murit të shtëpisë së tij dhe e pengon me rrjedhjen e ujërave nga kulmi i objektit të paditurit në murin e shtëpisë së paditësit.

**III. OBLIGOHET** i padituri E. Q. që në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi ta rrënojë murin e objektit me strehë, të ndërtuar në anën përendimore të ngastrës së të paditurit Nr.004..-0 ZK B., me gabarit 8.25 x 4.40 m në lartësi prej 3.40 m dhe të liroj hapësirën në anën lindore të shtëpisë së paditësit e cila gjendet në ngastrën kadastrale Nr.4..-0 ZK B. Dragash, ashtu që paditësit t’ia kthej gjendjen e fundit të posedimit faktik dhe të mos e pengojë në ushtrimin e shfrytëzimit të lirë të murit të shtëpisë, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi e nën kërkënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**IV. I NDALOHET** të paditurit që në të ardhmën ta pengojë paditësin që ta pengojë në ushtrimin e posedimit të lirë dhe të fundit faktik të paluajtshmërisë e cila gjendet në ngastrën nr.4..-0 ZK B., përmes ndërtimit të murit, strehës apo në ndonjë mënyrë tjetër me të cilën e pengon paditësin në ushtrimin e lirë të posedimit të shtëpisë së tij.

**V. OBLIGOHET** i padituri që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 200,00 € (dyqindeuro), në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përbarimit.

## A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në të dhënat e cekura në padinë e shkruar, të dhënat e cekura gjatë shqyrtimeve të mbajtura, e po ashtu edhe gjatë shqyrtimeve të mbajtura në vazhdimësi, si dhe në të dhënat e cekura në shqyrtimin perfundimtar dhe në të dhënat e cekura në fjalën e fundit të dhëna me shkrim me dt. 13.03.2023 ku ka bërë edhe precizimin e kërkesëpadisë, ka kërkuar që gjykata me administrimin e provave të mjaftueshme, konsiderojnë se tashmë janë vërtetuar faktet vendimtare për tu konstatuar se paditësi I. Q. ka qenë në posedimin e fundit faktik të pjesës së ngastrës Nr. 4.. ZK B. në të cilën i padituri me rastin e ndërtimit të shtëpisë e ka penguar paditësin në posedimin faktik duke vendosur murin dhe strehën në murin e shtëpisë së paditësit. Me këto veprime i padituri e ka penguar paditësin në posedimin e fundit faktik ashtu që tani uji i depërton në brendësi të shtëpisë e po ashtu streha bashkë me murin e pengon paditësin që të bëjë izolimin e shtëpisë dhe mirëmbajtjen e saj të vazhdueshme për sa i përket ujrave dhe kanalizimit. Pasi që padia është parashtruar në gjykatë në tetor të vitit 2021 nga ajo kohë e deri më tani, depërtimi i ujrave brenda shtëpisë së paditësit tashmë ka shkaktuar lagështi (mykë) në murët e brendshme të dhomave, duke ndikuar kështu drejtëpërdrejtë në dëmtimin e fasadës së brendshme dhe shkaktimit të erës së mykut. Në vazhdim ka dekluar se nisur nga dispozita e nenit 480 të LPK-së, posedimi i fundit faktik është vërtetuar nga ekspertiza e ndërtimtarisë dhe gjeodezisë në të cilën vërtetohet fakti se shtëpia e paditësit ka qenë e ndërtuar para se të ndërtohet objekti pengues nga ana e të paditurit.

Në vazhdim pas elaborimit të provave të adminstruara me degjimin e dëshmitarëve, ka argumentuar se ka vite që përpiqemi me marrëveshje t'i zgjidhim këto pengesa që na paraqitën nga ana e të paditurit, mirëpo nuk ka qenë e mundur që të na lejoj punimet mbrapa shtëpisë për izolimin dhe futjen në kanalizim të ujrave. Këto dy kërkesa (Izolimi dhe kanalizimi) konsiderojmë se janë kërkesa elementare që lejohen nga të gjithë fqinjët, ashtu siç iu është lejuar fasadimi i shtëpisë së vjetër të parëve tanë nga ana e prindit të paditësit. Për më tepër i padituri, për ta bërë të pamundur një gjë të tillë, tanime e ka ndërtuar edhe objektin streha e të cilit është e puthitur me shtëpinë e paditësit, e i cili është pengesë thelbësore për izolim. Për ne është i domosdoshëm izolimi i shtëpisë e sidomos tani në kohën kur promovohet izolimi për shkak të kursimit të energjisë, ndërsa nuk kemi punë tjera mbrapa shtëpisë, përveç nëse i padituri na paraqetë ndonjë pengesë të cilën duhet ta largojmë patjetër. Në fund i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë: për taksën gjyqësore shumë prej 50.00 euro, për ekspertizë 150 euro ose gjithsejtë shumë prej 200,00 euro.

Duke u përgjigjur në të dhënat e kësaj kerkesëpadie, i padituri gjatë shqyrtimeve të mbajtura si dhe në të dhënat e paraqitura në pergjigjen me shkrim në këtë padi të paditësit, e ka kundërshtuar në tërësi padinë e padisë. I padituri ka konsideruar se muri kontestues është i ndërtuar në pjesën e pronës së tij dhe se nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse se i padituri murin e paska ndërtuar në pjesën e paluajtshmërisë së paditësit dhe në këtë mënyrë e ka penguar paditësin. I padituri ka qenë dhe është në pronësi dhe posedim të pjesës së paluajtshmërisë ku është ndërtuar muri kontestues. Me rastin e ndërtimit të murit kontestues në prezencën e policisë dhe dëshmitarëve e palëve ndërgjyqëse, pra vetë paditësi me të paditurin kanë arritur marrëveshje lidhur me vendosjen dhe vendin e ndërtimit të murit. Bazuar në faktin se i padituri ka ndërtuar murin në vendin e vet dhe se ka qenë në posedimin e fundit faktik të asaj pjese të paluajtshmërisë, ai ndanë mendimin se nuk ka penguar paditësin.

Ndërsa në fjalën perfundimtare i autorizuari i të paditurit av. A. J. nga Prizreni dorëzuar kësaj gjykate me shkrim me datë 10.03.2023, mes tjerash ka deklaruar: që në fillim duhet të ceki

se konsiderojë se me provat e administruara nuk është vërtetuar kërkesëpadija e paditësit I. Q. nga fshati..., Komuna e Dragashit. Nuk është kontestuese se i padituri E. është një dhe i vetmi pronar i paluajtshmërisë edhe atë ngastrës kadastrale nr.4.-0 në vendin e quajtur “Mbi katund”, me kultur shtëpi dhe oborr ZK B. Ponjashtu konsiderojë se nuk është kontestues as fakti se i padituri nisur nga dera e oborrit të tij nga ana lindore ka ndërtuar murin në gjatësi 8 m dhe gjerësi 20 cm. për ekzistimin e aktit të pengim posedimit duhet që pretenduesi i cili kërkon vërtetimin e aktit të pengimit të ketë qenë në posedimin e fundit faktik të sendit – paluajtshmërisë. Pas elaborimit të të gjitha provave materiale dhe personale i ka propozuar gjykatës refuzimin e padisë dhe kërkesëpadiës së paditësit si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, duke bërë njëherit edhe specifikimin e tyre në shumën totale prej 910,00 €.

Kjo gjykatë në këtë çështje kontestimore ka marr për bazë thëniet dhe rekomandimet lidhur me evitimin e shkeljeve procedurale të cilat janë kërkuar me aktvendim të Gjykatës së Apelit AC.nr.4191/15 të dt. 05.05.2015 edhe atë rregullimin e padisë nga paditësi e në kuptim të nenit 99, 102.1 dhe 3 të LPK-së.

Paditësi duke vepruar sipas këtyre rekomandimeve, me datë 20.10.2023 përmes parashtrësës e ka bërë precizimin e kërkesëpadiës, ndërsa në seancat e mbajtura pas kthimit të lëndës nga Gjykata e Apelit, në tërësi ka mbetur pranë padisë së precizuar – kërkesëpadiës si dhe pranë parashtrësës së dt. 20.10.2023, ku i ka propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar. Ndërsa në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e paditësit ka qëndruar në tërësi sipas precizimit të padisë dhe deklaratave të mëhershme, por ka bërë ndryshim vetëm që në vend të fjalës “objekt” ashtu siq ka theksuar eksperti i ndërtimtarisë, do ta quajm “muri mbajtës i derës hyrëse”, kurse tjerat mbesin të pa ndryshuara. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë për taks dhe për ekspertiza.

I autorizuari i të paditurit av. A. J. nga Prizreni, ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi, të cekurave në shqyrtimet e mbajtura, të cekurave në ankesën e ushtruar, pranë provave të propozuara dhe të zbatuara nga kjo gjykatë, meqë dua të shtojë se për ekzistimin e aktit të pengim posedimit duhet që pala të ketë qenë në posedimin e fundit faktit të objektit të cilin është penguar. Sa i përket precizimit të padisë nuk ka asgjë drejtë, bazuar në të gjitha këto pajtohëm që gjatë procedurës së më tejshme gjykata ti zbatoj të njëjtat prova, që dëshmitarët e dëgjuar të mos ftohen gjegjësishtë të lexohen deklaratat e tyre. Në të gjitha këto prova sërish do të vihet në konkludim se i padituri ka qenë në posedimin e fundit faktit. Ndërsa në fjalën e fundit ka deklaruar se muri kontestues siq është deklaruar eksperti, është i ndërtuar në ngastrën kadastrale 4...-0 i cili ka qenë gjithmonë në posedim dhe pronësi të të paditurit. I njëjti mur është larg nga streha dhe objekti i paditësit në dimensione si në ekspertizë në seancën e dt. 07.03.2023 janë dëgjuar dëshmitari H. Q. i cili vërteton se i padituri E. që nga vitet 1980 e këndeje, në këtë vend e ka pasur hyrjen për objektin dhe oborrin e shtëpisë së tij dhe të njëjtin e ka shfrytëzuar. Dëshmitari B. Q. vërteton se hyrjen për në oborrin e shtëpisë dhe shtëpinë e të paditurit gjithmon e kanë shfrytëzuar këtu i padituri E., ndërsa paditësi këtë pjesë si hyrjen e po ashtu edhe oborrin e të paditurit e ka shfrytëzuar vetëm me rastin e ndërtimit të shtëpisë së tij, pra viteve të 70-ta e kurrë më. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata në shqyrtimin kryesor me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto prova: ka bërë shikimin në Certifikatën mbi patundshmërinë që mbanë numrin e lëndës 952-387/22 të dt. 13.07.2022 e që është në emër të të paditurit Enver Qafleshit, bëhet shiqimi në foto dokumentacion nga objekti kontestues dhe atë në 8 kopje të regjistruara në shkresat e lëndës duke filluar me numer 18 e përfunduar në numrin 25, lexohet

përmbajtja e raportit e dt. 07.09.2018 si dhe në skicën e ekspertit Xh. I., lexohet përmbajtja e raportit dhe shiqimi në skicë të ekspertit të ndërtimtarisë V. H. të dt. 14.09.2018, shiqimi në fotodokumentacion dhe atë në 7 fotografi, leximi i përmbajtjes së raportit të ekspertit L. M., leximi i përmbajtjes së ekspertizës së ekspertit gjeometër L. A. të dt. 20.09.2022 si dhe në riprocedurë ka dëgjuar përsëri ekspertin e gjeodezisë. Poashtu në cilësi të provave personale janë dëgjuar deshmimet edhe atë H. Q., B. Q., Xh. J. si dhe eksperti i ndërtimtarisë L. M., dhe pas vlerësimit të këtyre **provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së**, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi ka vërtetuar gjendjen faktike si më poshtë:

Nga leximi i çertifikates pronësore 952-387/22 të dt. 13.07.2022, gjykata vërteton faktin se ngastra kadastrale kontestuese nr.004..-0 në sipërfaqe prej 640 m2 evidentohet në emer të këtu paditësit E. Q. (L.) nga fsh. B.

Me shiqimin në fotodokumentacion nga objekti kontestues dhe atë në 8 kopje, gjykata ka vërtetuar faktin në lidhje me punimet e ndërmarra nga i padituri rreth ndërtimit të murit rrethues në afërsi të strehës, mbrapa shtëpisë të cilën paditësi e përdor për mirëmbajtje të shtëpisë.

Nga leximi i përmbajtjes së raportit të dt. 07.09.2018 si dhe në skicën e ekspertit Xh. I. si dhe leximit të përmbajtjes së raportit dhe shiqimit në skicë të ekspertit të ndërtimtarisë V. H. të dt. 14.09.2018, nga gjykata konstatohen raportet e dhëna nga të njëjtët ekspert në një rast tjetër që mban shenjë C.nr.55/18 e ku si palë paditëse ka qenë këtu i padituri E. Q. ndërsa si palë paditur këtu paditësi I. Q.

Me shiqimin në fotodokumentacion nga objekti kontestues dhe atë në 7 kopje, gjykata ka vërtetuar faktin që i padituri në pjesën e strehes nga ana e mbrapme e shtëpisë së paditësit ka vendosur blloqe nga betoni të ngjitura ndërmjet murit të shtëpisë së paditësit dhe shtyllës së betonuar të tij, duke penguar njëherit paditësin që të mirëmbajë strehën e tij.

Me leximin e raportit të ekspertit të ndërtimtarisë L. M. të dt. 22.09.2022 si dhe shiqimit në skic dhe foto të të njëjtit ekspert, gjykata ka vërtetuar faktin se eksperti fillimisht ka bërë identifikimin e ngastrave kadastrale respektivisht ngastrat kadastrale të paditësit I. Q. dhe të paditurit E. Q. të cilët posedojnë pronën dhe shtëpitë afër njëri tjetrit. Në anën lindore të shtëpisë së paditësit ndodhet hyrja për në ngastrën kadastrale 004...-0 të cilën e shfrytëzon i padituri dhe në këtë lokacion ka ndërtuar derën hyrëse për në oborrin e tij dhe kulmin mbi të me gabarite 8.25x4.40m. Në distancë nga shtëpia e paditësit prej 0.37 m është ndërtuar muri kufizues i cili është nga bllokat e betonit gjerësi 20 cm, gjatësi 8.0 m dhe lartësi 3.4 m. streha e shtëpisë së paditësit ndodhët në lartësi 2.6 m nga streha e këtij objekti. Në anën veriore të shtëpisë së paditësit ndodhën tre gypa vertical nga ollukat e kulmit të cilët nuk janë të kyqur në kanalizim. Si përfundim ka dhënë mendimin se për evitimin e lagështisë e cila paraqitet në brendësi të objektit – shtëpisë së paditësit është e mundshme nëse treha e objektit të paditurit vazhdohet deri afër murit të shtëpisë së paditësit dhe në tërë gjatësinë e objektit 8.25 m të vendoset lamarinë mbrojtëse – këndore të gjerësisë së shtruar 2.0.65 m e konform normave ndërtimore. Rrjedhja e ujit nga vertikallet e ollukave të kyqet në kanalizim ashtu që mos të ketë rrjedhje në sipërfaqe dhe grumbullim të ujit në objektin e të paditurit, gjatësia e kanalizimit përafërsisht 40 m. Të muratoset pjesa e rrënuar e murit në anën perendimore gjatësi 0.5 m dhe lartësi 2.6 m ashtu që mos të ketë mundësi qarkullimi në atë pjesë. Ndërsa në seancën e datës 24.01.2023 ka sqaruar se në bazë të shiqimit në vend edhe atë në anën e paditësit në brendi të objektit të tij vërehet lagështi në muret e shtëpisë së paditësit dhe se ky mur dhe objekt i ndërtuar nuk e konsideroj se është ndërtuar në bazë të standardëve të ndërtimit.

Me leximin e raportit të ekspertit të gjeodezisë L. A. të dt. 10.10.2022 si dhe shiqimit në skic dhe foto të të njëjtit ekspert, gjykata ka vërtetuar faktin se pas identifikimit të parcelave nr. 4...-0 me pronar të paditurin dhe parcelën 4..-0 ZK B. me pronar I. Q., gjykata vërteton faktin se përmes fotove të bëra nga i njëjti ekspert në vendin e ngjarjes por edhe nga skicat e përpiluara konstatohet për gjykatën që shtyllat e dyerve si dhe muri është ndërtuar pikërisht në pjesën nën strehën e pjesës së mbrapme të shtëpisë së paditësit. Ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor të dt. 13.05.2024 i njëjti ekspert i dëgjuar ka sqaruar se me inqizimin e gjendjes faktike në teren kemi paraqitur të gjitha elementet e nevojshme për ta pasur më të qartë gjendjen faktike, ku në situacionin e terrenit kemi dalluar me ngjyrë të verdhë pjesën e objektit të parcelës 329-0, ku kemi paraqitur diimensionet e objektit nga kufiri kadastral si dhe sipërfaqën prej 14 m<sup>2</sup> e ku besojmë që kanë qenë të mjaftueshme për ta pasur më të qartë gjendjen faktike me gjendjen kadastrale.

Nga dëgjimi i dëshmitarit H. Q. nga fshati B., me palët ndërgjyqëse kushëri, i njëjti ka deklaruar se: Kam qenë ndërmjetësues me B. dhe i kemi pajtue këtu palët në kontest, është fjala për një rast të mëhershëm. E di që paditësi ka dal në shtëpi në vitet 1970 ndërsa i padituri E. mendoj se në vitin 1980 dhe se i padituri që nga fillimi e ka pasur aty hyrjen.

Me dëgjimin e dëshmitarit B. Q., me palën paditëse kushëri ndërsa me të paditurin në gjini - vlla, i njëjti ka deklaruar: se kur është ndërtuar muri nuk kam qenë aty dhe kur kam ardhur pas tre muajve muri veq kishte qenë i ndërtuar. Nuk e di ku është ndërtuar muri por mendoj se e kanë vendosur si kanë thënë gjeodetët, ndërsa në lidhje me gjerësinë e hyrjes kur është blerë parcel aka qenë 4.20 ose 4.25 m. Dera hyrese para se që është ndërtuar kjo nuk ka pasur mur, muri është ndërtuar vonë një apo dy vite më parë. Është fakt që edhe paditësi e ka shfrytëzuar hyrjen e të paditurit kjo ngase edhe shtëpinë e ka ndërtuar nga ana e E. sepse ne kemi pasur muhabet dhe nuk ka pasur problem për ndërtimin e shtëpisë.

Me dëgjimin e dëshmitarit Xh. J. jo në gjini me palët, i njëjti veç tjerash ka deklaruar: Kam punuar tek i padituri te dera hyrëse, E. ka biseduar me I. dhe janë marrë vesh ku më ka thënë E. që ta vendosi pikën e perit unë edhe në atë vend e kam vëndos. Kam vazhduar punimet, e kam kryer punën. Unë kam vazhduar punimet dhe i kam përfunduar pa më kundërshtuar askush dhe besoj që edhe paditësi ka qenë i pajtimit. Policia ka qenë për faktin se kanë pasur këta ndonjë mosmarrëveshje, në atë kohë unë i kam larguar punëtorët e mi dhe pasi ata kanë kryer punën dhe ndoshta edhe janë marrë veshë, më ka thirë pronari më ka dhënë leje për të vazhduar punën dhe unë e kam vazhduar punën dhe përfunduar pa problem. Nuk e di a pengon apo jo muri së bashku me strehën por E. më ka thënë se ka qenë objekti ekzistues në atë formë dhe unë kam vazhduar punimet sipa marrëveshjes me pronarin. Sigurishtë për shkak të afërsisë ndoshta edhe pengon por kjo nuk është kompetenc e imja. Korniza e derës është ajo që ka qenë dhe ngjitur me kornizën e derës ka qenë e përforcuar dera me disa blloka, mur nuk ka pasur dhe ka qenë e mbuluar por unë nuk e di në çfarë pozicioni ka pasur ngase i padituri E. e kishte rrëzuar para se të shkoja unë. Mendoj që mes hapsira në mes murit të shtëpisë së paditësit dhe murit të derës hyrëse të të paditurit mund të jetë diku 20 cm nga muri i paditësit e deri te muri i që e kam ndërtuar unë.

Në lidhje me këtë çështje në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), parashihet se **“personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”**. Me nenin 113 par. 1 të këtij ligji është e paraparë se **“nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkoj rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...”**, ndërsa me paragrafin 2 të tij ceket se **“nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkoj nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkoj mbrojtje gjyqësore”**. Në lidhje me çështjen në fjalë, duke u bazuar në nenin 480 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata është kufizuar vetëm **në konstatimin dhe provimin**

***e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjen që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit.***

Në rastin tonë konkret, të gjitha provat e lartpërmendura vërtetojnë se i padituri me ndërmarrjen e punimeve rreth ndërtimit të objektit (muri dhe vendosjes së qatisë mbi mur), pa mëdyshje është vërtetuar nga gjykata objekti i kontestit, respektivisht pengimi i posedimit të lirë dhe faktik të pjesës së strehës, mbrapa shtëpisë së paditësit. Dhe krejt kjo duke marrë për bazë të gjitha provat e administruara si më lartë, ku qartë është vërtetuar se i padituri tani me këto punime të kryera përreth strehës së shtëpisë së paditësit, ia ka pamundësuar të njëjtit mirëmbajtjen e shtëpisë në lidhje me depërtimin e ujit nga të reshurat atmosferike nga streha e qatisë mbi murin kontestues të ndërtuar nga pala e paditur, pastaj pengesën që muri bashkë me strehën i shkakton paditësit rreth izolimit të shtëpisë si dhe duke marrë për bazë edhe raportin e ekspertit të ndërtimtarisë, futjen e rrjedhjeve të ujit nga vertikalet e olluqëve me kyqje në kanalizim ashtu që mos të ketë rrjedhje sipërfaqësore dhe grumbullim të ujit në objektin e të paditurit, gadishmëri kjo të cilën edhe paditësi e ka shprehur gjatë shqyrtimeve për ta kryer, mirëpo si rezultat i mosmarrëveshjeve me palën e paditur ka qenë e pamundur që të kryet, ndërkaq me veprimet e ndërmarra tani kur edhe është vendosur muri, vetëm sa e ka ndërlikuar situatën edhe ashtu të tensionuar mes palëve ndërjegjësore.

Se deri te akti i pengim posedimit ka ardhur me veprimet e kundërligjshme të paditurit kjo u vërtetua me veprimet e lart cekura e të cilat janë në kundërshtim me nenin 78 të LPDTS-së, ku thuhet: *“Pronarët e paluajtshmërive fqinjë janë të detyruar që ti marrin parasysh të drejtat dhe interesat e fqinjëve të tyre dhe të drejtat e tyre t’i ushtrojnë ashtu që të mos cenohen apo dëmtohen të drejtat e fqinjëve të tyre”*, andaj në rastin konkretë i padituri duke ndërtuar murin në pjesën e pronës së tij dhe brenda strehës nga pjesa e mbrapme e shtëpisë së paditësit ka ardhur deri tek akti i pengim posedimit ndaj paditësit, për shkak se i njëjti nuk mund ta mirëmbajtë atë pjesë si rezultat i murit të ndërtuar dhe ngushtimit të strehës së paditësit në vetëm 0.37 m, fakt ky i cili është vërtetuar edhe nga konstatimet dhe mendimet e eksperteve të lëmisë së ndërtimtarisë dhe gjeodezisë, ku sa për ilustrim po permendim skicën e “Situacion Tereni” (me numer rendor 56/6 nga shkresat e lëndës) e nga e cila skicë mjaftë kjo sqarohet me vija të ndërprera me ngjyrë të kuqe se të gjitha veprimet punuese janë kryer brenda strehës së objektit të paditësit gjegjësisht ndërtimi i murit dhe vendosja e çatisë mbi këtë mur.

Andaj, gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë për shkak të pengim posedimit është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provuarit të fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të bërë siç përcaktohet në nenin 480 të LPK-së, ku paditësi e ka pasur në posedim strehën, dhe është trazuar në posedim të qet nga i padituri me veprimet e tij të kundërligjshme, ndërsa nga dëshmitë e dëshmitarëve është konstatuar se paditësi ka pas të ndërtuar shtëpinë qysh në vitet 1970 ndërsa i padituri gjatë vitit 1980, faktë ky që vërteton posedimin e fundit faktit të paditësit në pjesën kontestuese.

Ndërkaq duke u ndërlidhur me pretendimet e të autorizuarit të të paditurit av. A. J. nga Prizreni se i padituri E. Q. ka ndërtuar murin me dimensionet përkatëse në pronën e tij dhe se paditësi asnjëherë nuk ka qenë në shfrytëzim të oborrit të të paditurit, gjykata vlerëson se në kontestet e kësaj natyre rreth pengim posedimit fare nuk lëshohet në konstatim të të drejtave pronësore por vetëm brenda kriterëve të përcaktuara me nenin 480 të LPK-së rreth *konstatimit dhe provimit të fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit*, ndërkaq nga provat e shtjelluara dhe administruara më lartë, veqanërisht nga ekspertizat gjegjëse mjaftë arsyeshëm është provuar që të gjitha punimet ndërtimore nga pala e paditur janë ndërmarrë nën strehën e pjesës së mbrapme të shtëpisë së paditësit dhe asnjëherë nuk është kontestuar nga paditësi se ai

ka shfrytëzuar oborrin e tij por pretendimi që të lihet hapsirë e mjaftueshme në lidhje me strehën të cilën paditësit i nevojitet ta mirëmbajë nga rreziku rreth depërtimit të ujrave atmosferik në brendi të shtëpisë (tashmë të konstatuar edhe me fotografimin Nr.94/1) si dhe izolimit të shtëpisë dhe kanalizimit. Ndërkaq me nenin 78 të LTDPS-së i padituri do të duhej të ketë parasysh përveç të drejtave të tij pronësore në lidhje me autorizimet ligjore për shfrytëzim dhe posedim, edhe detyrimet sa i përket mos cenimit të drejtave të fqinjit të tij respektivisht këtu paditësit Isuf Qafleshi.

Në lidhje me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 par.1 të LPK-së, dhe atë për shpenzimet si në vijim: taksa për padi në shumën prej 50,00 €, shpenzimet për ekspert (gjeodezisë 50 € dhe atë të ndërtimtarisë 100 €) shumën prej 150,00 €, përkatësisht shumën e tërësishme të shpenzimeve procedurale në lartësi prej 200,00 €.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 103 të Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, në lidhje me nenin 480 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2023:217883, 12.06.2024**

**G j y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj Gjykate.